

*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

E drejta për “Gjykim të Drejtë”

Monitorimi i seancave gjyqësore të ndërlidhura me rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të autoritetit publik

DHJETOR 2013



E drejta për “Gjykim të Drejtë”

Monitorimi i seancave gjyqësore të ndërlidhura me rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të autoritetit publik

Projekti “Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike” mbështetet nga:



Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga Civil Rights Defenders - CRD dhe Open Society Foundation - OSF. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e CRD dhe OSF.

Përmbajtja:

Hyrje	4
Detyrimi për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në Kosovë	5
Parakushtet për një gjykim të drejtë	6
Gjykata e pavarur dhe e paanshme	8
Pavarësia e gjykatës	8
Emërimi/zgjedhja e Gjyqtarëve	9
Kohëzgjatja e mandatit dhe parimi i përgjithshëm i mos largimit nga detyra	9
Ekzistimi i mbrojtjes adekuate të gjyqësorit dhe anëtarëve të saj nga presionet e jashtme	10
Paraqitja e jashtme e gjykatës si e pavarur	11
Paanshmëria e sistemit gjyqësor	11
Paanshmëria subjektive	12
Paanshmëria objektive	12
Përfundime lidhur me parimin për Gjykatat e Pavarura dhe të Paanshme të themeluara me Ligj	13
Monitorimi i realizimit të drejtave për gjykim të drejtë në procedurat penale	14
Të Gjeturat e monitorimit të seancave gjyqësore	18
Rekomandime	24
Përfundime	22

Hyrje

Monitorimi i seancave gjyqësore të ndërlidhura me rastet e korrupsionit, është pjesë e Projektit “Mbështetje për Politikat Anti-Korrupsion duke forcuar Inspektimin Publik mbi Shërbimet Publike”, të Lëvizjes FOL i mbështetur nga Civil Rights Defenders (CRD). Qëllimi i monitorimit është nxjerrja e të dhënave të nevojshme për vlerësim në kontekstin e “Gjykimit të Drejtë” në rastin e seancave të monitoruara.

E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj, përbën një ndër të drejtat më themelore të njeriut. Si e tillë, ka zënë vendin e merituar në të gjitha instrumentet ndërkombëtare dhe regjionale. Republika e Kosovës, si një ndër shtetet më të reja në botë ka dëshmuar përkushtimin dhe zotimin për ti zbatuar duke i’u dhënë edhe përparësi në zbatim në krahasim me ligjet vendore. Sidoqoftë, mëshirimi i këtyre zotimeve në aktin më të lartë juridik përkatësish në Kushtetutë përbën hapin e parë në këtë drejtim, përderisa zbatimi praktik përpos vullnetit politik të institucioneve kërkon edhe përgjegjshmëri dhe përkushtim në krijimin e parakushteve për një sistem adekuat gjyqësor në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në Raportin vjetor të vitit 2012, ka përcaktuar si detyrë të sistemit, përqendrimin në zhvillimin dhe zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe për sigurimin e të dhënave të qarta statistikore të harmonizuara me institucionet tjera relevante për të ndjekur progresin. Për më tepër, është zotuar të angazhohet në “fuqizimin e transparencës dhe llogaridhënës sw gjyqësorit dhe në demonstrimin e përkushtimit të gjyqësorit në ngritjen e kapaciteteve për të gjykuar rastet e nivelit të lartë, por edhe për të dekurajuar dhe sanksionuar korrupsionin brenda gjyqësorit dhe organeve të tij”.

Prandaj edhe pritjet kanë qenë që gjatë vitit 2013, do të ketë raste të cilat do të përcjellin angazhimin e KGJK, dhe të gjithë sistemit në luftimin e korrupsionit

përmes garancive të ofruara të cilat do të përmbushin plotësisht standardet e kërkuara për një gjykim të drejtë.

Ky raport mëton që të bëjë një analizë krahasuese standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, si dhe zbatimin praktik të tyre, për të identifikuar mangësitë e sistemit në zbatim të këtyre standardeve.

Gjatë hartimit të këtij punimi, kryesisht janë shfrytëzuar metodat krahasimore dhe analitike lidhur me standardet ndërkombëtare në temën e lartpërmendur.

Detyrimi për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në Kosovë

Ndryshe, njihet si një ndër të drejtat themelore në të gjitha konventat ndërkombëtare ndër të tjera në Deklaratën universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të gjitha këto konventa të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar në mënyrë eksplicite përparësi për zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare në nenin 22, *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”*¹

Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka fuqizuar në nenin 53, detyrimin e institucioneve publike të Kosovës për interpretimit të së drejtës ndërkombëtare, gjegjësisht Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

¹ http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf faq. 6

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”².

Ky nen, i cili i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimit dhe interpretimit të praktikës gjyqësore të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, ka një rëndësi të veçantë ngase formulimi i nenit të lartpërmendur nuk e përcakton këtë detyrim vetëm për institucionet gjyqësore, por pa përjashtim për të gjitha institucionet publike pa përjashtim. Duke theksuar se ky standard duhet të zbatohet gjithmonë në rastet kur vendoset për të drejtat e njeriut në Kosovë. Sidoqoftë, objekt i shqyrtimit të këtij punimi është standardi për një gjykatë të pavaruar të paanshme të themeluar me ligj, prandaj sfidat në zbatimin praktik të këtij neni nuk do të jenë pjesë e shqyrtimit.

Parakushtet për një gjykim të drejtë

Dy prej konventave ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, kanë përcaktuar standardin për të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur e paanshme dhe e themeluar me ligj. Objekti i kësaj kërkesë për gjykatë të themeluar me ligj është për të krijuar siguri dhe pavarësi të sistemit gjyqësor. Kërkesa për këtë standard gjithashtu, obligon për ligje mbi themelimin e sistemit gjyqësor ose të gjykatave, të aprovuar nga parlamenti dhe jo nga degët tjera të pushtetit, veqënisht kërkon evitimin e ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv. Për më tepër gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka nxjerr qëndrim se në vendet në të cilat ka pas kodifikim të ligjit, organizimi i sistemit gjyqësor nuk mund ti lihet as diskrecionit të gjyqësorit gjithashtu, por duke mos përjashtuar mundësin e gjykatave për të interpretuar legjislacionin përkatës vendor.³

²http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf faq. 22

³ *Cowme dhe të tjerët kundër Belgjikës* [2000] KEDLNJ 250, para 98.

Përkufizimi i termit “e themeluar me ligj” përfshin, jo vetëm bazën juridike për themelimin e gjykatave, por gjithashtu edhe përbërjen dhe kompetencat e organeve gjyqësore. Ligji gjithashtu duhet të ofroj bazë të mjaftueshme për sqarimin e situatave për papërshtatshmërinë dhe largimin e gjyqtarëve.

Çështja e dytë kyçe për parimin e gjykatës së themeluar me ligj, mbetet që secila seancë dëgjimore individuale të jetë në pajtim të plotë me ligjin. Me fjalë të tjera përkufizimi “ e themeluar me ligj” mbulon jo vetëm bazën juridike për themelimin gjykatës por edhe përbërjen e secilës degë në raste individuale, përfshirë edhe situatat e zëvendësimit të gjykatësve. Në rastin *Posokhov v Ruisë*, gjykata evropiane për të drejtat e dhe liritë e njeriut gjeti se, dështimi për të emëruar gjyqtarët porotë për periudhë më të gjatë se ajo e përcaktuar me ligjin për Gjyqtar Porotë, nuk është në pajtim me parimin e “gjykatës së themeluar me ligj”⁴

Derisa lidhur me formën e gjykatës nëse ajo duhet të jetë në përbërje me gjyqtar porotë apo gjyqtar profesional, Komiteti për të drejtat e njeriut ka theksuar se KNDCP, nuk përmban ndonjë përcaktim lidhur me këtë çështje. Baza themelore sipas komitetit është se të gjitha gjykimet duhet të jenë në pajtueshmëri me parimin e gjykimet të drejtë.⁵ Gjithashtu, gjykata evropiane për të drejtat e njeriut në disa raste ka vlerësuar se gjykimet me porotë ekzistojnë në lloje të ndryshme në shtete të ndryshme por duke reflektuar historinë, traditën dhe kulturën juridike të shtetit. Për më tepër gjykata e lartpërmendur ka vlerësuar gjithashtu se zgjidhja e një sistemi të caktuar penal të shteteve përkatëse është jashtë fushës së mbikëqyrjes së gjykatës evropiane dhe duke u kufizuar në vlerësimin nëse sistemi përkatës në raste konkrete është në pajtueshmëri me standardet e KEDLNJ.

⁴ *Moiseyev kundër Ruisë* [2008] GJEDLNJ 1031, para 179.

⁵ Komunikata e Komitetit për të drejtat e njeriut 819/1998, UN Doc CCPR/C/71/D/819/1998 (2001), para 10.1

Gjykata e pavarur dhe e paanshme

Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor përbëjnë shtyllën qendrore për gjykim të drejtë.

Pavarësia e sistemit gjyqësor nënkupton, se gjykatat duhet të jenë të lira nga çdo formë e ndërhyrjes së drejtpërdrejt apo tërthorët, pavarësisht nëse kjo ndërhyrje vjen nga qeveria, palët e përfshira në procedurë apo edhe palët e treta si mjetet e informimit apo mediat⁶.

Ndërsa paanshmëria është garanci e cila është ngushtë e lidhur me parimin e barazisë para gjykatës që përfshin në vete idenë e trajtimit të barabartë për të gjithë. Kjo garanci nënkupton se gjyqtari duhet të ushtroj funksionin e tij pa paragjykim dhe anshmëri personale dhe në mënyrë që ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim për paanshmërinë e tij. Ky parim për paanshmëri dhe pavarësi kërkohet në mënyrë të njëjtë si nga gjyqtarët porotë ashtu edhe ata profesional.

Pavarësia e gjykatës

Nëse një organ gjyqësor është i pavarur apo jo, janë katër kritere themelore të cilat zakonisht vlerësohen:

- Mënyra e emërimit të gjyqtarëve
- Kohëzgjatja e mandatit dhe parimi i përgjithshëm i mos largimit nga detyra
- Ekzistimi i mbrojtjes adekuate të gjyqësorit dhe anëtarëve të saj nga presionet e jashtme
- Paraqitja e jashtme e gjykatës si e pavarur

⁶ Parimet Themelore të KB për pavarësinë e gjyqësorit, të aprovuara më 1985 nga Asambleja e Përgjithshme, rezolutat 40/32 dhe 40/146, para 4: “Nuk do të ketë asnjë ndërhyrje të papërshtatshme apo të padëshiruar në procesin gjyqësor”.

Emërimi/zgjedhja e Gjyqtarëve

Në shtete të ndryshme zbatohen praktika të ndryshme të emërimit të gjyqtarëve. Në disa shtete ata emërohen nga këshillat gjyqësor, në disa të tjerë nga populli dhe në disa raste të tjera ata zgjedhën pas një procesi të hapur të konkurrimit. Sidoqoftë kërkesë kryesore gjithmonë mbetet që mos të ketë ndërhyrje nga shtyllat e tjera të pushtetit qoftë legjislativ apo ekzekutiv.

Këshilli i Evropës, rekomandon që zgjedhja e gjyqtarëve duhet të bëhet nga një autoritet i pavarur nga qeveria dhe administrata⁷, ndërsa shoqata e gjyqtarëve të Evropës në mënyrë të drejtpërdrejt deklaroi se përzgjedhja e gjyqtarëve duhet të bëhet nga një mekanizëm i pavarur i cili përfaqëson gjyqtarët⁸.

Sidoqoftë, nga shumica e ekspertëve të drejtësisë, pavarësia në përzgjedhjen e gjyqtarëve është konsideruar si një nga komponentët më të rëndësishme për një sistem gjyqësor efektiv. Përndryshe çfarëdo varësie që mund të krijohet në mes të sistemit të gjyqësorit dhe degëve tjera të pushtetit mund të kërcënoj funksionimin e pavarur të sistemit gjyqësor qoftë përmes kontrollit të pagave për gjyqtarë, përmes transferimit të tyre në gjykata tjera dhe nivele tjera gjyqësore apo edhe përmes udhëzimit të gjykatave.

Kohëzgjatja e mandatit dhe parimi i përgjithshëm i mos largimit nga detyra

Kriteri i lartpërmendur ka të bëjë me kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit, me çka gjyqtarëve do t'u ofrohen një pavarësi në punën e tyre nga ndërhyrjet e jashtme në nxjerrjen e vendimeve të cilat mund të jenë të kundërta me bindjet dhe presionin e publikut apo faktorëve të tjerë dhe e cila si pasojë do të ndikonte

⁷ Parimi 1, pika 2, shkronja c) e *Rekomandimit R (94) 12 e KE*

⁸ http://www.deontologiejudiciaire.umontreal.ca/fr/textes%20int/documents/INTERNATIONAL_BAR_A55.pdf faq.24

në shkarkimin apo largimin e tyre. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e konsideron këtë kriter si pjesë integrale e pavarësisë së sistemit të gjyqësorit. Megjithatë deri më sot nuk ka ndonjë kërkesë lidhur me afatin minimal të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit por i vetmi kriter i cili kërkohet të plotësohet është që të ketë një afat të caktuar kohor. Sidoqoftë sa më i gjatë që të jetë mandati i gjyqtarit aq më tepër krijohet siguri për pavarësinë e tij.

Gjithashtu, ky kriter mbulon edhe fushën e gradimit, pagës adekuate, pensionin, transferimin, suspendimin apo edhe largimin nga detyra dhe kushtet e tjera të cilat lidhen me ushtrimin e mandatit të gjyqtarit. Sidoqoftë, të gjitha këto çështje kërkohet të jenë të rregulluara me ligj. Komiteti për të Drejtat e Njeriut i KB-së, ka sqaruar se largimi i gjyqtarëve nga detyra mundë të ndodhë vetëm nën rrethanat e “shkeljeve serioze të keqpërdorimit të detyrës ose të jo kompetencës në pajtim me procedura të drejta të cilat sigurojnë objektivitet dhe paanshmëri siç përcakton ligji apo kushtetuta”⁹

Ekzistimi i mbrojtjes adekuate të gjyqësorit dhe anëtarëve të saj nga presionet e jashtme

Kriteri në fjalë ka për qëllim themelor ofrimin e mbrojtjes adekuate, përmes procedurave dhe mekanizmave që do të siguronin mbrojtje nga çdo ndërhyrje e jashtme në fushëveprimin e sistemit gjyqësor. Prandaj, lidhur me të njëjtën rolet dhe kompetencat e ekzekutivit dhe gjyqësorit duhet të jen plotësisht të ndara. Çdo situatë tjetër kur qeveria mund të kontrolloj apo drejtoj sistemin gjyqësor përbën shkelje të këtij parimi dhe konsiderohet si kërcënim apo shkelje e pavarësisë së sistemit. Kjo mbrojtje shpeshherë merr formën e imunitetit në ushtrimin e mandatit zyrtar, me qëllim të ofrimit të sigurisë nga çfarëdo forme e përndjekjes eventuale nga cilado palë duke përfshi ato shtetërore lidhur me vendimet e marra për çështjet në kompetencë të gjyqtarit.

⁹ Komiteti për të Drejtat e Njeriut i KB, Komentet e Përgjithshme 32 (2007), par. 20.

Në përgjithësi, sanksionimi dhe persekutimi i gjyqtarëve lidhur me vendimet e marra gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare është në papajtueshmëri të plotë me obligimet dhe parimet ndërkombëtare për pavarësinë e sistemit të gjyqësorit.

Paraqitja e jashtme e gjykatës si e pavarur

Kriteri i fundit lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të gjyqësorit, ka të bëjë me paraqitjen e jashtme të pavarësisë e cila përfshin më tepër mundësinë e ndërhyrjes hipotetike në pavarësinë e gjyqësorit.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se gjykatat duhet të shihen si të pavarura nga ekzekutivi dhe legjislativi në të tri fazat e procedimeve gjyqësore, duke përfshi hetimin, seancat dëgjimore dhe vendimin.

Paanshmëria e sistemit gjyqësor

Një nga çështjet themelore të një sistemi adekuat gjyqësor në shoqëritë demokratike është se, ato duhet të gëzojnë besimin e qytetarit në punën e tyre. Paanshmëria nga teoricienët e drejtësisë është konsideruar se përbën dy elemente kryesore mbi bazën e të cilave mundë të vlerësohet paanshmëria.

E para, ka të bëjë me paanshmërinë objektive të sistemit gjyqësor, dhe e dyta ka të bëjë me paanshmërinë subjektive. Megjithëse, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka pas të vështirë të bëjë dallimin e qartë në mes të këtyre dy koncepteve sepse shpeshherë bindja subjektive e gjyqtarit përkatës pasqyron edhe atë objektive të gjykatës.

Paanshmëria subjektive

Mbi bazën e parimit të paanshmërisë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionin e tyre pa paragjykime personale ndaj procesit apo palëve të përfshira në proces apo edhe natyrës së çështjes e cila procedohet nga ai. Sidoqoftë gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka afirmuar parimin se gjykatat duhet të prezumohen të jenë të lira nga bindjet personale derisa të mos dëshmohet e kundërta¹⁰. Ky parim gjithashtu reflekton një nga elementet e rëndësishëm të sundimit të së drejtës, përkatësisht se vendimet përfundimtare të gjykatave janë të zbatueshme përveç në rastet kur gjykatat më të larta kanë konstatuar parregullsi apo padrejtësi.

Paanshmëria subjektive, pretendon të përcaktoj nëse në rastin konkret ka pas bindje personale të gjyqtarit të cilat kanë pas ndikim në procedurë apo edhe në nxjerrjen e vendimit.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, deri më tani ka konstatuar shkeljet më të mëdha të këtij parimi në situatat kur gjyqtarët janë prononcuar lidhur me rastet në shqyrtim para mediave duke prezantuar bindjet personale lidhur me çështjen (*Buscemi kundër Italisë*, 1999 70, par. 67).

Paanshmëria objektive

Lidhur me paanshmërinë objektive, është çështje themelore që gjyqtarët gjatë ushtrimit të mandatit zyrtar ta bëjnë këtë duke ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim lidhur me paanshmërinë e tyre, me fjalë të tjera do të duhej që në sytë e një monitoruesi të arsyeshëm gjykata të duket e paanshme. Një shpjegim të përafërt më të lartpërmendurën ka dhënë edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë praktikës gjyqësore lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë.

Sidoqoftë, në kuptimin praktik paanshmëria objektive përbën dy anë të medaljes.

¹⁰ *Hauschildt kundërDenimarkës* [1989] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 7, para 47

Në një rën anë, është obligim i përgjithshëm i autoriteteve publike (shtetërore), që të mbroj sistemin gjyqësor nga ajo që njihet si konflikt i interesit, duke siguruar se organizimi i brendshëm i gjykatave do të parandaloj ushtrimin e detyrave të ndryshme procedurale nga gjyqtar i i njëjtë. Ndërsa në anën tjetër, përbën obligim të veçantë për gjyqtarët individual që të parandalojnë vetveten për përfshirje në rastet në të cilat mund të duket ose mund të ngritën pretendime për konflikt interesi. Komitetit i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut¹¹ dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në përpjekje për të ofruar vlerësime testuese nëse ky parim mund të jetë shkelur kanë vlerësuar se në rastet e dyshimeve të arsyeshme për shkelje të parimit të objektivitetit është me rëndësi nëse frika e bazuar për shkelje mund të arsyetohet në mënyrë objektive.

Në një rast të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Castedo kundër Spanjës*, pretendimi i parashtuesit të ankesës se gjykata në rastin e tij e kishte shkelur parimin e paanshmërisë ishte pranuar, sepse gjyqtari i rastit kishte gjykuar duke qenë i përfshirë në rast si i punësuar i një universitetit i cili ishte palë e kontestit në procedurë gjyqësore.

Gjithashtu, pjesëmarrja e gjyqtarit në kapacitete të ndryshme në të njëjtin rast gjatë procedimeve përbën shkelje të parimit të objektivitetit. Siç ndodh në rastet e përfshirjes në rolin e prokurorit pastaj të gjyqtarit apo edhe të gjyqtarit në të dyja nivelet e ankimit.

Përfundime lidhur me parimin për Gjykatat e Pavarura dhe të Paanshme të themeluara me Ligj

Lidhur me standardet e lartpërmendura FOL, konsideron se në përgjithësi sistemi gjyqësor vepron në pajtueshmëri me parimet e analizuara dhe garancitë të cilat ofrojnë instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

¹¹ Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara , Komete të përgjithshme 32 (2007), par. 19

Themelimi i gjykatave dhe emërimi i gjyqtarëve është në pajtueshmëri me këto standarde, megjithatë një prej sfidave të vazhdueshme dhe të debatuar mbetet paanshmëria e gjyqtarëve qoftë ajo subjektive apo objektive.

Rastet e monitoruara nga FOL, kryesisht janë udhëhequr nga panelet e gjyqtarëve të Misionit të EULEX-it, që në parim krijojnë bindjen dhe perceptimin e një pavarësie objektive dhe subjektive, në mënyrë të veçantë për shkak të procesit të tyre të emërimit dhe mungesës së lidhjeve eventuale subjektive me rastet në proces.

Perceptimi i publikut, në shumicën e këtyre rasteve i ka falur besimin në paanshmëri dhe pavarësi të gjyqtarëve në bazë të automatizimit. Për faktin se nuk kanë qenë të ndikuar në procesin e emërimit nga fuqia politike vendore ose edhe për faktin se është vështirë të argumentohet ndikimi subjektiv që mund të kenë lidhur me cilindo rast për shkakun se të gjithë janë gjyqtar ndërkombëtar të cilët nuk mund të kenë krijuar bindje subjektive.

Megjithatë, situata nuk duket të jetë e njëjtë me gjyqtarët vendor, në shumicën e rasteve të proceduarave nga Prokurori Disiplinor, janë të karakterit të konfliktit të interesit apo dështimit të zbatimit të parimit të paanshmërisë. Sidoqoftë mbetet shqetësuese se pothuaj në të gjitha këto raste, vendimet e nxjerra mbi bazën e procedurave të iniciuar nga Prokurori Disiplinor janë hedhur poshtë. Kjo përbën një tregues shqetësues për sistemin dhe mekanizimin e mbikëqyrjes së punës së gjyqtarëve.

Monitorimi i realizimit të drejtave për gjykim të drejtë në procedurat penale

Meqenëse, “gjykimi i drejtë” përbën çështjen kyçe për cilindo shtet me qëllim të sigurimit të rendit në emër të shoqërisë dhe për ti mbajtur përgjegjës njerëzit për krimet e kryera dhe në fund për të siguruar që drejtësia është zbatuar. Ky veprim i pushtetit në vetvete mbartë edhe përgjegjësi të madhe, sepse akuzimi i

një personi për vepër penale dhe kufizimi i lirisë si veprim potencial pothuaj në të gjitha rastet e tilla përbën një nga ndërhyrjet më të ashpra të pushtetit ndaj personit. Ky veprim i pushtetit mund të arsyetohet vetëm nëse personit i është ofruar një gjykim i drejtë.

Një gjykim i drejtë nënkupton se njerëzit mund të jenë të sigurt se procesi gjyqësorë do të jetë i drejtë. Një proces i tillë parandalon edhe qeverinë nga keqpërdorimi i pushtetit. Gjykimi i drejtë është mjete më i mirë për të ndarë fajësinë nga pafajësia dhe mbrojtjen kundër padrejtësive. Pa këtë të drejtë sundimi i ligjit dhe besimi publik në sistemin gjyqësor falimenton. Kjo e drejtë gjithashtu përbën gur themelin e një sistemi juridik.

Pranda, lidhur me këtë fokusi kryesor i këtij raporti ka qenë monitorimi i procedurave gjyqësore penale në çështjet e korrupsionit dhe shpërdorimit të autoritetit publik, sa i përket plotësisht të parakushteve të përcaktuar si më poshtë.

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tija civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit. Vendimi shpallet publikisht por prania në sallën e gjyqit për përfaqësuesit e shtypit dhe të publikut mund të ndalohet kur një gjë të tillë e kërkon interesi i ruajtjes së moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve, mbrojtja e jetës private të palëve në gjykim, tërësisht ose në atë masë që gjykata e mendon rreptësisht të nevojshme në rrethana të

veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

2. Çdokush që akuzohet me një vepër penale duhet të konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia para ligjit.
3. Çdokush që akuzohet me një vepër penale ka të drejtat minimale si më poshtë:
 - (a) Të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe arsyen e akuzës kundër tij;
 - (b) Të posedojë kohën dhe mundësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij;
 - (c) Të mbrojë veten e tij personalisht ose përmes asistencës ligjore që ai vetë e zgjedh ose, nëse ai nuk ka mundësi që të paguajë për asistencë ligjore, t'i sigurohet kjo asistencë falas kur interesat e drejtësisë kërkojnë kështu;
 - (d) Të marrë ose të ketë marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të ftoj e të marrë në pyetje dëshmitarë në emër të tij në të njëjtat kushte sikurse dëshmitarët kundër tij;
 - (e) Të ketë asistencën e lirë të një përkthyesi nëse ai nuk mund ta kuptojë ose të flas gjuhën e cila përdoret në gjykatë;

Parime pothuaj të njëjta janë fuqizuar edhe në ligjet vendore, përkatësisht në Kodin e Procedurës Penale të republikës së Kosovës. Megjithatë, duke konsideruar dispozitat kushtetuese sidomos neni 22 i cili fletë për përparësin e zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare ndaj atyre vendore në raste të konfliktit të dispozitave gjithmonë përparësi u epet mekanizmave ndërkombëtar.

Kodi i Procedurës Penale ka njohur dhe fuqizuar përcaktime të ngjashme si në:

Neni 3

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe *in dubio pro reo*

1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.
2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 5 Gjykimi i drejte, i paanshëm dhe ne afat te arsyeshëm

1. Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për veprë penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.
2. Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.
3. Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet

zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.

4. Kushdo që është privuar nga liria me arrest menjëherë njoftohet në gjuhën që e kupton për arsyet e heqjes së lirisë. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës sillet para gjyqtarit të gjykatës themelore në juridiksionin e arrestimit brenda dyzet e tetë (48) orëve. Gjyqtari vendos për caktimin e paraburgimit, në pajtim me Kapitullin X të këtij Kodi.

Të gjeturat e monitorimit të seancave gjyqësore

Çështja në Gjykatën Themelore Prishtinë

Të akuzuar ishin dhjetë persona. Rasti është iniciuar nga Prokuroria Speciale e EULEX-it. Në bazë të nenit 304 dhe 305 të Kodit të Procedurës Penale.

Monitoruesit e FOL-it, kanë monitoruar procedurën lidhur me rastin e lartpërmendur në nëntë seanca të zhvilluar si në vijim: 29 mars 2013; 11 prill 2013; 12 prill 2013; 15-16 maj 2013; 23-24 maj 2013; 29-30 maj 2013; 6 qershor 2013; 12 qershor 2013 dhe 17 qershor 2013.

Në seancën e parë, veçohet profili i lartë profesional i trupit gjykues, dy nga të cilët ishin gjyqtarë ndërkombëtar dhe një vendor. Kryetari i trupit gjykues, në pajtim të plotë me kërkesat e përmendurat më lartë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në fillim dhe në çdo seancë pasuese vazhdimisht i ka njoftuar të akuzuarit për të drejtat e tyre. Posaçërisht vlen të përmendet kujdesi i shtuar për ndërhyrje lidhur me mbarëvajtjen e procesit gjyqësor duke përkujtuar prokurorinë dhe mbrojtjen që t’i përmbahen çështjes kryesore dhe procedurës ligjore.

Seancat gjyqësore, pothuaj gjithmonë kanë filluar në kohën e përcaktuar, ndërsa në një rast edhe më herët ngase ishte planifikuar në shpalljen publike por trupi gjykues u arsyetua duke theksuar se palët në procedurë ishin njoftuar me kohë.

Gjithashtu, lidhur me mundësin dhe kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes gjithmonë është akorduar kohë e mjaftueshme dhe në asnjë rast nuk ka pas vërejtje nga palët e përfshira në këtë proces lidhur me atë që njihet si “barazia e armëve në procedurë penale”, përkatësisht kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

Një shembull të tillë përbën seanca e 23-24 maj 2013, kur prokuroria kishte prezantuar si prove një dokument për të cilin mbrojtja deklaroi se nuk e kishin pranuar me kohë dhe se lidhur me të njëjtën nuk ishin respektuar procedurat. Trupi gjykues vendosi që të përjashtoi shqyrtimin e kësaj prove duke ju referuar parimit të “barazisë së armëve”.

Po ashtu, në seancën e 29-30 maj 2013, trupi gjykues kishte kërkuar nga mbrojtja të mos përgjigjej në pyetjet e prokurorisë të cilat kishin të bënin me përgjimet telefonike dhe të cilat ishin të natyrës personale. Prandaj edhe trupi gjykues reagoi duke mbrojtur dinjitetin e të akuzuarit në procedurë.

Një aspekt shumë i rëndësishëm të kësaj çështje është edhe përmbushja e plotë e standardit për një “gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor”. Seanca e parë kishte filluar në mars dhe në vazhdimësi dhe pa zvarritje të panevojshme ishin zhvilluar për çdo muaj seanca dhe në muajin qershor ishte shpallur aktgjykimi. Në më pak se tre muaj ishin zhvilluar të gjitha seancat dhe ishte shpallur aktgjykimi në pajtim të plotë po ashtu me kodin e procedurës Penale dhe me një arsyetim adekuat dhe korrekt duke trajtuar secilën provë veç e veç dhe duke i vlerësuar po të njëjtat.

Derisa, lidhur me të drejtën e përfaqësimit adekuat dhe efektiv, gjithashtu trupi gjykues është dëshmuar të jetë shumë i kujdesshëm duke njoftuar të akuzuarit

për të drejtat por edhe duke u ofruar kohë të mjaftueshme për konsultime me avokatët mbrojtës rreth çështjeve në procedurë. Si aspekte negative veçohen sidomos sjellje jo korrekte e avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarve ndaj prokurorisë dhe dëshmitarëve. Në disa raste kryetarja e trupit gjykues ka konsultuar të akuzuarit lidhur me paqartësitë që janë krijuar nga avokatët mbrojtës lidhur me çështjet kyçe.

Veprime të tilla kanë përfshi por nuk kanë qenë të kufizuara në përcëpimi dhe përbuzje të prokurorisë duke trajtuar si të njëanshme dhe tendencioze dhe se gjoja procesi është inskenuar për qëllime të caktuar dhe akuza është selektive ndaj të akuzuarve. Por gjithmonë në mungesë të argumenteve ose provave të cilat do të pretendonin të mbështesin këtë lloj reagimi.

I njëjti trajtim u është bërë edhe dëshmitarëve në procedurë nga të akuzuarit, duke pëshpëritur me fjalë përbuzëse dhe nënçmuese të cilat deri në një masë kufizohen me pengimin e dëshmitarit në prezantimin e dëshmisë gjatë procesit gjyqësor.

Lidhur me Prokurorinë, duhet theksuar se si aspekte negative ka qenë tendenca për të shfrytëzuar prova të cilat më herët ishin shpallur si të paligjshme. E në disa raste gjithashtu është tentuar të dilet jashtë objektit të akuzës duke komentuar edhe përmbajtjen e SMS-ve, të cilët ishin të natyrës intime dhe që në fakt nuk përbënin asnjë lidhje me objektin e akuzës.

Çështja në Gjykatën Themelore të Prizrenit, seancat e 25 marsit 2013, dhe tri të tjera gjatë muajit korrik

Në këtë çështje, ishte ngritur akuza më 27 shkurt 2013, ndaj gjashtë të akuzuarve për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe ose autoritetit.

Edhe në këtë çështje trupi gjykues ishte në përbërje të dy gjyqtarëve ndërkombëtar dhe një vendor. Trupi gjykues gjatë të gjitha seancave ka qenë në përbërje të plotë. Po ashtu trupi gjykues gjatë gjithë procedurave dhe seancave ka vepruar në pajtim të plotë me procedurën penale, duke bërë në fillim të çdo seance konfirmimin e pjesëmarrjes së të akuzuarve dhe njoftimin për të drejtat e tyre. Po të njëjtën qasje ka dëshmuar edhe me ofrimin e kohës së nevojshme, për përgatitje të mbrojtjes.

Trupi gjykues ka dëshmuar profesionalizëm në mbrojtje të procesit dhe të dinjitetit të gjykatës në rastet e tendencave për fyerje dhe përbuzje të palëve në proces. Derisa, shpeshherë gjatë seancave procedurale nga mbrojtja ka pas tendenca të pengimit të zhvillimit të procesit përmes formave indirekte të ndërhyrjes në formë të përbuzjes apo komenteve kur prokuroria vlerësonte apo komentonte mbi dëshmitë.

Gjithashtu, gjatë seancave në përfaqësim të akuzës është vërejtur tendencë e njëjtë e cila ngrit shqetësime mbi rolin e pavarur dhe të paanshëm të prokurorisë.

Përfundime

Zotimi i institucioneve publike të Republikës së Kosovës për zbatimin e standardeve ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të fuqizuara me Kushtetutë, kërkojnë përkushtim shumë më të madh praktik. Sistemi gjyqësor Një ndër shtyllat kryesore të pushtetit në të gjitha sistemet demokratike duhet të ketë synim parësor mbrojtjen adekuate të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Megjithatë, sistemi i tanishëm ekzistues nuk siguron mbrojtje adekuate, shembull i tillë përbën rasti i mungesës së mekanizmit adekuat efektiv në rast të shkeljeve të së drejtës për qasje në gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Në hyrje të këtij punimi është diskutuar detyrimi kushtetues për zbatimin e praktikës gjyqësore në rastet e vendosjes për të drejtat e njeriut. Megjithatë në praktik pothuajse nuk ka asnjë rast të tillë i cili ka marrë për bazë praktikën gjyqësore dhe interpretimet e gjykatës lidhur me çështjen e lartpërmendur. Mbetet që në këtë kuadër Republika e Kosovës të ndër marr hapa urgjent për të sjell në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare zbatimin praktik të zotimeve të marra në kornizën juridike në fuqi.

Për më tepër është më se e nevojshme që edhe kurrikulumet e fakulteteve juridike qoftë publike apo private të ndryshojnë për të siguruar mundësin e prodhimit të gjeneratave të juristëve të cilët pastaj do të jenë në gjendje të zbatojnë këtë praktik gjyqësore dhe që përfundimisht efekti të jetë jo vetëm i ndjeshëm por edhe i matshëm për qytetarët e saj.

Kjo është e rëndësishme edhe për faktin se Republika e Kosovës aspiron anëtarësimin në Këshillin e Evropës dhe me këtë edhe ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo që do të mbetet si sfidë pastaj është situata që mund të pasoj sepse qytetarëve të saj u ofrohet mundësia që lidhur me pretendimet për shkeljet e të drejtave të njeriut të kërkojnë mbrojtje pranë mekanizmit të kësaj konvente e që është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kuptohet nëse kjo situatë nuk shënon përmirësim atëherë vendimet eventuale të gjykatës mund të ndikojnë ndjeshëm edhe në aspektin ekonomik siç ka ndodhur me disa shtete tjera në Evropë ku për pasoj të rasteve të humbura është rrezikuar ndjeshëm edhe buxheti shtetëror.

Në një situatë ku gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët janë në pamundësi ose kanë mungesë vullneti për të përbushur përgjegjësit, ndër të tjera, për hetimin dhe iniciimin e procedurave penale kundër zyrtarëve publik të dyshuar për korrupsion ose shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimi i së drejtës nuk mund të mbahet dhe të drejtat e njeriut nuk mund të zbatohen. Nuk është vetëm individi i cili do të vuaj nga një situatë e tillë, por është i gjithë sistemi kushtetues dhe demokracia e shtetit do të jenë në rrezik.

Gjithashtu, sigurimi i besimit të qytetarëve të vendit diktohet nga veprimet e sistemit në rastet e interesit publik. Pothuaj të gjitha instrumentet ndërkombëtare¹² të cilat flasin për rolin e prokurorisë trajtojnë në mënyrë të posaçme dedikimin e prokurorëve në hetimin dhe ndjekjen penale për krimet e kryera nga zyrtarët publik, posaçërisht korrupsionin, keqpërdorimin e pushtetit, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe krimet e njohura sipas së drejtës ndërkombëtare.

Pa plotësimin e këtyre parakushteve të përmendura më lartë, nuk mund të flitet për pavarësinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe sistemin prokurorial në veçanti.

¹² Guidelines on the Role of Prosecutors, september 1990, e qasshme në <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RoleOfProsecutors.aspx>

Rekomandime

Trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm për gjyqtarë lidhur me të drejtat e njeriut të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare, përbën çështjen themelore për zbatim praktik në sistemin e brendshëm juridik vendor. Pa një edukim të tillë të vazhdueshëm, zbatimi i të drejtave të njeriut të njohura në instrumentet ndërkombëtare do të mbetet iluzion.

Prokurori për faktin se vepron në emër të shoqërisë në tërësi dhe për shkak të pasojave serioze që sjell akuza duhet të veproj me standarde më të larta se avokati në procedurën civile. Roli i prokurorit nuk është që me çdo kusht dhe çmim të siguroj dënimin, ai duhet të prezantoj dëshmi dhe fakte kredibile para gjykatës dhe nuk mundë të zgjedhë se çka mund ti përshtatet apo jo dhe gjithashtu ai duhet ti prezantoj të gjitha faktet e jo vetëm ato që i shkojnë atij në favor.

I njëjti standard profesional dhe etik duhet të zbatohet edhe në rastet kur ekzistojnë prova dhe dëshmi të cilat do të mjaftonin për një procedurë të drejtë gjyqësore dhe për një dënim meritore, veçërisht për rastet për krimet e zyrtarëve të larë publikë. Monitorimi i deritashëm ka dëshmuar që përkundër numrit të iniciuar të rasteve të nivelit të lartë dhe vëmendjes publike që tërheqin këto raste, shpeshherë në praktik ndodh në mënyrë të qëllimshme apo të pa qëllimshme, që akuza të mos mundë të vërtetohet për shkak të sigurimit të provave në mënyrë të paligjshme ose për arsye tjera të cilat e dëmtojnë besimin e përgjithshëm të qytetarëve në pavarësinë e funksionit të prokurorisë.

Duhet të ndërmerren të gjitha masat me qëllim të sigurimit të standardeve sa më të larta të edukimit juridik dhe etik, si parakushte për tu regjistruar në profesion dhe gjithashtu duhet siguruar trajnim të vazhdueshëm për avokat.

Edukimi profesional juridik, duke përfshirë programet e vazhdueshme të edukimit duhet të kenë për qëllim fuqizimin e shkathtësive juridike, vetëdijesimin për etikën profesionale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në rastet kur avokatët nuk veprojnë në pajtim me standardet profesionale të përcaktuara në kodet e Odës së Avokatëve apo të dispozitave të legjisllacionit, duhet ndërmarrën masa adekuate duke përfshi edhe ato disiplinore.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Civil Rights Defenders - CRD dhe Open Society Foundation - OSF. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.

*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*



Rr. Andrea Gropa, Nr. 35. 10000 Prishtinë, Kosovë

Mob.: +377 (0) 44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org

Projekti “Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike” mbështetet nga Civil Rights Defenders - CRD dhe Open Society Foundation - OSF.